

**SKEMA PËR VLERËSIM TË TESTIT NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA
PAS PËRFUNDIMIT TË KLASËS IX, QERSHOR 2016**

DETYRA 1. : *ANALIZË DHE INTERPRETIM*

Klasikë të letërsisë shqipe dhe botërore

1 pikë

DETYRA 2.: është rrethuar numri 2. “Dita 2000”

1 pikë

DETYRA 3.: është rrethuar numri 1. Marsela Pushani

1 pikë

DETYRA 4. : *epikës/ prozës epike*

1 pikë

DETYRA 5. : është rrethuar numri 3. Santjago

1 pikë

DETYRA 6. : nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të sakët

Të qarit e djaloshit _____4_____

Mbrëmja e ftohtë _____

Ardhja në shtëpi _____3_____

Beteja e humbur _____2_____

Lufta me peshkaqenë _____1_____

DETYRA 7.: *Dëshprueshëm*

1 pikë

DETYRA 8.: Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë: *rrëfimin dhe dialogun*

(Vërejtje: Nëse nxënësi shkruan vetëm dialog ose vetëm rrëfimin, merr 0 pikë, si dhe nëse pranë përgjigjes së saktë ka shkruar edhe përgjigjen e pasaktë.)

DETYRA 9.: Djaloshi qante për arsye se i dhimbej plaku që e kishte shumë vështirë derisa luftonte me peshkaqenët, gjë që shihej edhe nga duart e tij të plagosura/për arsye se nuk kishte qenë me plakun t'i ndihmonte në luftë me peshkaqenët *etj.*

1 pikë

DETYRA 10.: Kur ngjarja rrëfehët në vetën e tretë, kurse realiteti pasqyrohet objektivisht, thuhet se rrëfen i ashtuquajtur i rrëfyesi që i di të gjitha *etj.*

1 pikë

DETYRA 11.:Nxënësi merr **1 pikë** nëse rrethon numrin 2 dhe ka shpjeguar përgjigjen: P.sh. Motivet statike më së shpeshti janë përshkrimet, kurse motivi dinamik shënon veprimin *(etj.)*.

(Vërejtje: Nxënësi merr 1 pikë edhe nëse nuk e ka rrethuar numrin 2, por që nga shpjegimi është e qartë se ka menduar në motivin dinamik.)

Nxënësi merr 0 pikë nëse vetëm ka rrethuar saktë përgjigjen (2. motivi dinamik) por nuk e ka shpjeguar përgjigjen ose e ka shpjeguar gabimisht.)

DETYRA 12.: Nxënësi merr **2 pikë** nëse i ka nënvizuar të gjitha fjalët e shkruara saktë:

rrënjëshkulës, rrëqethës, rrëshqanë, çamarrok

Nxënësi merr **1 pikë** nëse i ka nënvizuar dy ose tri fjalë të shkruara saktë ose ka nënvizuar të katër fjalët e shkruara saktë, por me to ka nënvizuar edhe një fjalë të shkruar gabim.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka nënvizuar saktë një fjalë të shkruar saktë.

DETYRA 13.

Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë:

Rri pa lëvizur.	S	P
Nuk ia bën syri tërr.	S	P
Në kohën e vet.	S	P
Me zë të thellë.	S	P

DETYRA 14.

A) është rrethuar numri 3. njëri-tjetri **1 pikë**

B) gjithsej **2 pikë** (nxënësi merr nga 1 pikë përgjigjen e plotë të saktë

14 - katërbëdhjetë **1 pikë**

900 – nëntëqind **1 pikë**

DETYRA 15.

A) Nxënësi merr **1 pikë** për përgjigjen e plotë të saktë, domethënë për shkrimin e saktë të shenjave të pikësimit:

E ku mund të mbajë ajo një valixhe!?- tha me zë të lartë.

B) Në kohën e kryer të tejshkuar

1 pikë

DETYRA 16.: është rrethuar numri 3. Nga sytë i dilte një egërsim i rrallë plot zemërim dhe pezëm.

1 pikë

DETYRA 17.: gjithsej **3 pikë** (nxënësi merr nga **1 pikë** për çdo përgjigje të plotë dhe të saktë – e shkruar saktë vepra dhe emri dhe mbiemri i autorit):

PERSONAZHI	VEPRA LETRARE	EMRI DHE MBIEMRI I AUTORIT TË VEPRËS	
Tana	<i>Katërbëdhjetë vjeç dhëndër</i>	<i>Andon Zako-Çajupi</i>	1 pikë
Plaka Nicë	<i>Gjenerali i ushtrisë së vdekur</i>	<i>Ismail Kdare</i>	1 pikë
Gorio	<i>Xha Gorio</i>	<i>Onore de Balzak</i>	1 pikë

DETYRA 18.

- A) *apostrofa* **1 pikë**
B) *onomatopesë* **1 pikë**

DETYRA 19.

A)

1. Çdo vijë e fytyrës, çdo lëvizje e dorës, çdo fjalë, çdo hap i Skënderbeut tregonte njeriun e veprave të mëdha. - **1 pikë**
2. E keqja njeriut nuk i vjen nga urtësia, por nga mendjemadhësia. - **1 pikë**

B)

1. Ndarja e gjymtyrëve homogjene pa lidhëza - **1 pikë**
2. Ndarja e gjymtyrëve homogjene që bashkohen me lidhëzën kundërshtore por - **1 pikë**

DETYRA 20.

Skema për vlerësimin e ditarit me temën *Kasollja e plakut*

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi:

merr 1 pikë për përshkrimin më të thjeshtë të kasolles në krahasim me shtëpizat tjera të fshatit të peshkatarëve.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt se si e imagjinon pamjen e jashtme të kasolles.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi:

merr 1 pikë në qoftë se shkruan shkurt se si e imagjiron brendësinë e kasolles.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi:

merr 1 pikë nëse më thjeshtë shkruan çfarë flet pamja e kasolles për kushtet e jetës së peshkatarëve të atjeshëm.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi:

merr 1 pikë për një sqarim më të thjeshtë se çfarë do të bënte nëse do ta shikonte një peshkatar të moshuar dhe të lodhur në kasollen e tij.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, përdorimi i figurave stilistike</p> <p>2 pikë</p>	<p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës; rumbullakimi kuptimor i fjalisë, renditja e saktë e fjalëve në fjali)</p> <p>2 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p>	<p>→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike</p> <p>1 pikë</p>

	<p>Gjithsej 4 pikë <u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja të fjalitë e ndërmjetme, inversioni, të fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë</p>		
--	--	--	--